

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, i përbërë nga trupi gjykues-gjyqtari Vesel Ismaili, kryetar dhe gjyqtaret profesioniste Valbona Musliu Selimaj dhe Naime Jashanica, anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Nurije Rexhëbeqaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit, nga fshati Komuna e i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorise Themelore ne Prishtine,- Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.498/2003 dt.30.12.2013, për kryerjen e veprës penale Zotërimin, posedimit apo përdorimit të armës nga neni 8.3 qe ndëshkohet sipas nenit 8.5 të Rregullorës së Unmikut nr.2001/7 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Bukurije Gjonbalaj, të akuzuarit, mbrojtësit të tij av. i angazhuar sipas detyrës zyrtare, te dëmtuarit në dt. 21.05.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

, i biri i dhe e gjinisë i lindur me dt. në fshatin , Komuna e me vendbanim në fshatin Komuna e i martuar baba i ëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme, axhustator, i gjendjes se dobët ekonomike, i gjykuar për vrasje, dhe i dënuar, gjendet në vuajte të dënimit, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par. 1 nën par.1.1 të KPPRK-së.

REFUZOHET AKTAKUZA

Sepse:

Me datën 07.11.2002, ka përdorur armën me qellim të kërcënimit dhe frikësimit në atë mënyrë që rreth orës 21.40 minuta ka shtirë disa here me pushkë automatike në dritaren e lokalit të furrës ne rrugën në pronë të dëmtuarëve dhe ashtu që i dëmtuari i cili gjendej brenda lokalit është frikësuar dhe pas ndaljes se të shtënave, i njëjti e thërret Policinë dhe e lajmëron rastin, ku në vendin e ngjarjes gjenden gëzhojat e pushkës automatike .

- **Më çka kishte për te kryer veprën penale Zotërimi , posedimi , apo përdorimit të armës të parashikuar nga neni 8.3 që ndëshkohet sipas nenit 8.5 të Rregullorës së Unmikut nr.2001/7 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosove.**

Sepse përfaqësuesi i aktakuzës Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare të kësaj qeshtje juridike-penale hoqi dorë nga ndjekja e mëtejme penale ndaj të akuzuarit

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

I dëmtuari ka heqë dorë nga ushtrimi i kërkesa pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë–Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.nr.489/2003 dt.30.12.2013, e ka akuzuar të pandehurin **për kryerjen e veprës penale** Zotërimin posedimit , apo përdorimit të armës të parashikuar nga neni 8.3 që ndëshkohet sipas nenit 8.5 të Rregullores së Unmikut nr.2001/7 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë, të kryer në dëm të dëmtuareve dhe

Lidhur me këtë çështje gjykata zhvilloi seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë.21.05.2018. në të cilën seancë prokurori i shtetit Bukurije Gjonbalaj në fjalën përfundimtare thekson se pas administrimit të gjitha provave gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, dhe pas dëgjimit të dëmtuarit-dëshmitarit leximi të dëshmisë se dëshmitarit dhënë ne prokurori 20.02.2007, dhe mbrojtjen e të akuzuarit nuk u vërtetua se tani i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilat akuzohet, andaj konform nenit 52 të KPPRK-së heqë dorë nga ndjekja e mëtejme penale.

Pasi që përfaqësuesi i Aktakuzës ka heq dorë nga ndjekja e mëtejme penale , në shqyrtim gjyqësor gjykata konform nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK-se, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ne përputhje me nenin 454 par.1 të KPPK-se, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PKR.1142/13 dt.21.05.2018

Procesmbajtësja
Nurije Rexhëbeqaj

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari
Veseli Ismaili

UDHËZIM JURIDIK

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.